



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"  
REKTORATI

Nr. 168 Prot

Gjirokastrë, më 31.01. 2025

MIRATOI  
REKTORI

Prof. dr. Jaho CANA

**Lënda:** Hapen thirrjet për shkrimin e projekt propozimesh në kuadër të programit Horizon Europe me temë Iniciativa Inovative Shëndetësore (Innovative Health Initiative JU Call 9).

Në kuadër të Programit Horizon Europe, janë hapur thirrje të reja për projekt propozime, si më poshtë vijon:

Nr	Thirrja	Afati i fundit i dorëzimit të projekt propozimit
1	Innovative Health Initiative JU Call 9	29 prill 2025

Kjo thirrje synon të financojë kërkime shkencore dhe inovacione konkurruese për mjete, metoda, teknologji të reja etj. që do të nxisin zhvillimin e inovacioneve shëndetësore të cilat kontribuojnë për të parandaluar, diagnostikuar, trajtuar dhe menaxhuar sëmundjet, si dhe për të mundësuar rikuperimin në mënyrë më efektive.

Aplikuesit duhet të krijojnë një konsorcium që nxit bashkëpunim midis partnerëve nga sektori publik dhe privat, me qëllim pasqyrimin e natyrës integruese dhe ndërsektoriale të IHI JU (Innovative Health Initiative JU).

Disa nga pikat kryesore që duhet të marrin parasysh aplikantët në projekt propozimet e tyre janë si më poshtë:

a. të adresojnë një nevojë të paplotësuar të shëndetit publik bazuar në të paktën një nga opsionet si vijon:

- barra e lartë e sëmundjes për pacientët dhe/ose shoqërinë për shkak të ashpërsisë së saj dhe/ose numrit të personave të prekur prej saj;
- ndikimi i lartë ekonomik i sëmundjes për pacientët dhe shoqërinë;

- natyra transformuese e rezultateve të mundshme në proceset e inovacionit ku projektet nuk fokusohen në fusha individuale të sëmundjes (p.sh. analitika e të dhënave shëndetësore).

b. të ketë qasje të përqendruara tek njerëzit dhe jo te produkti dhe patologjia – fokusi është në udhëtimin e pacientit dhe qytetarit përmes kujdesit shëndetësor, me ndihmën e teknologjive më të përshtatshme shëndetësore dhe inovacioneve sociale dhe duke marrë parasysh tendencat demografike;

c. të demonstrojnë aftësinë për të përkthyer kërkimin shkencor në zgjidhje inovative që mund të integrohen/zbatohen në ekosistemin e kujdesit shëndetësor (duke marrë parasysh natyrën e fragmentuar të sistemeve evropiane të kujdesit shëndetësor) dhe/ose në proceset industriale.

Nëse është e aplikueshme, aplikantët pritet të marrin në konsideratë ndikimin e mundshëm rregullator të rezultateve të parashikuara të projektit dhe, sipas rastit, të zhvillojnë një strategji rregullatore dhe plan ndërveprimi për gjenerimin e provave të përshtatshme dhe për angazhimin me rregullatorët dhe organet e tjera në kohën e duhur, p.sh. Autoritetet kompetente kombëtare të BE-së, agjencitë e vlerësimit të teknologjive shëndetësore (HTA) dhe Agjencia Evropiane e Barnave (EMA) etj.

Aplikantët duhet të marrin në konsideratë iniciativat/projektet përkatëse ekzistuese për të siguruar sinergji dhe për të shmangur mbivendosjet e panevojshme dhe dyfishimin e përpjekjeve. Propozimi duhet të përfshijë një plan se si ata propozojnë të sinergjizohen me këto iniciativa.

Thirrjet, manualin e aplikimit dhe afatet e dorëzimit mund t'i gjeni në portalin e EU Funding & Tenders Portal: (<https://ec.europa.eu/info/funding-tenders/opportunities/portal/screen/opportunities/topic-details/HORIZON-JU-IHI-2025-09-03-single-stage?isExactMatch=true&status=31094501,31094502&order=DESC&pageNumber=1&pageSize=50&sortBy=startDate>)

Gjithashtu, mund të kontaktoni me Sektorin e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Kërkimit Shkencor për informacion më të detajuar.

**Zv. Rektore për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Kërkimin Shkencor**

**Prof.asoc. Merita Isaraj**